

Vendim nr. 247, datë 03.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 03.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (L) 2025 të Regjistrimit
Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LEONARD TROKTHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-559, datë 18.02.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji organik i Gjykatës*); ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); nenet 11, 15 dhe 24 të ligjit nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9171/2004*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është emëruar oficer aktiv në Forcat e Armatosura në vitin 1986, në zbatim të urdhrin nr. 38, datë 11.09.1986 të ministrit të Mbrojtjes. Në vijim, me urdhrin nr. 427, datë 10.09.2003, po të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesit i është dhënë grada ushtarake “Major”.

2. Gjatë vitit 2008 kërkuesi ka marrë pjesë në procesin e konkurrimit për marrjen e gradës së radhës “Nënkolonel”. Në përfundim të këtij procesi kërkuesi nuk është vlerësuar nga komisionet e karrierës si kandidaturre fituese, për rrjedhojë nuk e ka përfutuar gradën. Në vijim, me urdhrin nr. 1256, datë 03.09.2009 të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi është nxjerrë në rezervë.

3. Kërkuesi i është drejtuar me ankesë ministrit të Mbrojtjes dhe pas një viti i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 1762, datë 08.03.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 706, datë 29.03.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Ndërkohë, me urdhrin nr. 1665, datë 11.11.2009 të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi është riaktivizuar si ushtarak aktiv me gradën “Major”, për një periudhë njëvjeçare, ndërsa me urdhrin nr. 1599, datë 03.09.2010, të po atij organi, ai është rikthyer në shërbimin aktiv në Forcat e Armatosura dhe është riaktivizuar me të njëjtën gradë “Major”.

5. Në vijim, me urdhrin nr. 930, datë 27.05.2011 të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi është liruar nga detyra dhe është nxjerrë në rezervë, për shkak të përmbushjes së afatit maksimal të shërbimit në gradën “Major”, si dhe mosmarrjen e gradës së radhës në bazë të ligjit nr. 9171/2004.

6. Në datën 27.05.2016 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi, duke kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e pavlefshmërisë relative të urdhrave të ministrit të Mbrojtjes nr. 1256, datë 03.09.2009 “Për daljen në rezervë të oficerit aktiv”, për pikën 1 (91) dhe nr. 930, datë 27.05.2011, detyrimin e palës së paditur të nxjerrë aktin administrativ, urdhrin për dhënien e gradës “Nënkolonel” për paditësin dhe kthimin në punë të tij në një funksion sipas gradës, si dhe pagimin e pagës, sipas gradës, që nga data 02.05.2008 e në vazhdim për kohën e qëndrimit në gradën “Major” dhe më vonë si ushtarak në rezervë. Në përfundim të atij gjykimi, gjykata administrative e shkallës së parë, me vendimin nr. 6275, (80-

2016-6297) datë 27.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj. Kundër atij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4486 (86-2017-4765), datë 01.11.2017, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ajo gjykatë ka shqyrtuar dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha kërtimeve të ngritura në padi. Kundër vendimit kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-559, datë 18.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

9. Në datën 16.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit organik të saj, është regjistruar në datën 26.06.2025.

10. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të sigurisë juridike*, pasi nuk ka shqyrtuar në mënyrë të përshtatshme të gjitha pretendimet, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët në proces. Kërkuesi pretendon se gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim dhe nuk kanë bërë pjesë të debatit gjyqësor, nuk kanë pasqyruar as në përmbajtje e as në arsyetim faktin se ai është shpallur fitues në konkurrimin për marrjen e gradës së radhës në vitin 2008, brenda afatit ligjor, sipas shkresës nr. 6273/1 prot., datë 05.09.2008 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për dhënien e gradës “Nënkolonel” sipas shkresës nr. K2/L39-15, datë 05.11.2014. Gjithashtu,

kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë duhet të kishte bërë një analizë të vendimeve gjyqësore objekt rekursi për shkeljet procedurale, si dhe në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara.

11.1.2. *Të drejtës për t'u dëgjuar*, pasi kërkuesi ka pretenduar se e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor është cenuar edhe në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar për shkak se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve pa pjesëmarrjen e tij.

11.1.3. *Standardit të arsyetimit*, pasi vendimet e të tria shkallëve janë arsyetuar vetëm formalisht mbi bazën e provave të paraqitura nga Forcat e Armatosura, ndërkohë që nuk kanë analizuar asnjë provë të paraqitur prej tij. Edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë janë pasqyruar shkaqet e rekursit, por nuk janë pasqyruar parashtrimet e paraqitura në atë gjykatë pesë ditë përpara seancës edhe pse kishin të bënin me cenimin e së drejtës për punë të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës në aspektin procedural dhe substancial.

11.2. *E drejta për punë*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të organit shtetëror që kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e karrierës së kërkuesit në Forcat e Armatosura.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në çështjen konkrete, kërkuesi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtjen e tij ka kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave më të ulëta të marra në atë proces gjyqësor ku ai ka qenë palë ndërgjyqëse. Në këtë mënyrë, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore për të cilën ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe e drejta për punë.

14. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e pavlefshmërisë relative të urdhrin nr.1256, datë 03.09.2009 të ministrit të Mbrojtjes “Për daljen në rezervë të oficerit aktiv” për pikën 1 (91) dhe të urdhrin nr. 930, datë 27.05.2011, e cila është rrëzuar me vendim të Kolegjit Administrativ të asaj gjykate, vendimi i të cilit është edhe objekti i ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, mban datën 18.02.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 16.06.2025. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

16. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të sigurisë juridike, së drejtës për t’u dëgjuar dhe të standardit të arsytimit. Megjithëse këto pretendime janë ngritur si të mëvetshme, ato janë argumentuar nga kërkuesi dhe kanë të bëjnë në thelb me mënyrën sesi kanë arsyetuar dhe argumentuar gjykatat e të tria shkallëve vendimet e tyre për rrëzimin e kërkesës së tij, prandaj do të shqyrtohen në vazhdim në kuadër të pretendimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

17. Po kështu, edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për punë*, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, duhet mbajtur në konsideratë se argumentet për këtë pretendim lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe në këtë mënyrë duhet të shqyrtohet në

këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

18. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura nga kërkuesi, rezulton se ai ka ushtruar lirisht të drejtën e padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes dhe në respektim të së drejtës së disponimit të palës që e ka vënë në lëvizje atë, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për atë që i ka kërkuar gjykatës. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, kërkimet në padi, pretendimet e parashtruara nga palët, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke i argumentuar ato lidhur me respektimin e ligjit në nxjerrjen e urdhrin nr. 930, datë 27.05.2011 të ministrit të Mbrojtjes, në bazë të të cilit ai është liruar nga detyra dhe është nxjerrë në rezervë për shkak të përmbushjes së afatit maksimal të shërbimit në gradën "Major", si dhe për mosmarrjen e gradës së radhës në bazë të ligjit nr. 9171/2004, i cili në thelb ka qenë edhe shkak i padisë së ngritur nga ai.

20. Këto gjykata, ndër të tjera, kanë arsyetuar se paditësi me riaktivizimin e tij si ushtarak aktiv e ka pranuar vazhdimin e marrëdhënies së tij të punës me palën e paditur me gradën "Major" dhe ka qëndruar në këtë detyrë deri më 27.05.2011, kur është nxjerrë në rezervë me urdhrin nr. 930, datë 27.05.2011 "Për daljen në rezervë të oficerit aktiv" të ministrit të Mbrojtjes. Paditësi me vullnetin e tij të lirë ka pranuar vazhdimin e marrëdhënies së punës me palën e paditur me gradën "Major" përreth dy vjet, duke mos kundërshtuar administrativisht dhe gjyqësisht, brenda afateve ligjore, mosdhënien e gradës "Nënkolonel" nga pala e paditur.

21. Gjithashtu, gjykatat kanë arsyetuar se edhe në rastin konkret është plotësuar koha minimale dhe maksimale e qëndrimit në një gradë pa u graduar në një gradë më të lartë, duke passjellë në mënyrë të detyrueshme nxjerrjen në rezervë të ushtarakut, duke e gjetur të mbështetur

në ligj urdhrin nr. 930, datë 27.05.2011 “Për daljen në rezervë të oficerit aktiv” të ministrit të Mbrojtjes.

22. Këto vendime i janë nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Lartë, e cila, pavarësisht arsytimit të kufizuar, ka evidentuar rrethanat e rastit dhe ecurinë e procesit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, përfshirë dhe vendimmarrjet dhe argumentet e tyre, sikundër po ashtu ka evidentuar edhe shkaqet e parashtruara në rekursin e kërkuarit, duke vlerësuar se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim, pra se shkaqet e ngritura në të nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji ose janë haptazi të pabazuara. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për standardin e arsytimit në lidhje me vendimet e gjykatave të zakonshme është haptazi i pabazuar.

23. Ndërsa për pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, kërkuari ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke i mohuar mundësinë e realizimit të një mbrojtjeje efektive të drejtpërdrejtë. Kolegji çmon se, në thelb, pretendimi i kërkuarit lidhet me formën e gjykimin të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në dhomën e këshillimit, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuarit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore (pa ose me praninë e palëve).

24. Sipas ligjit procedural, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuarit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimin të përcaktuar nga ligji. Për më tepër, një formë e tillë gjykimi edhe në rastet kur rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk është vlerësuar nga Gjykata se cenon të drejtën e palëve për t’u mbrojtur dhe dëgjuar, duke u shprehur se shqyrtimi i rekursit në seancë në dhomën e këshillimit, pra mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr.41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, vetëm fakti se rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk përbën shkak për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar nga ajo gjykatë në aspektin kushtetues. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

25. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës për punë janë haptazi të pabazuara.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.